

Ftesë për Tender

23.07.2025

Tender i hapur vendor, Referencë: ITT/IHS/2025/001

Swiss Tropical and Public Health Institute (Swiss TPH) është duke implementuar projektin e quajtur: “Shërbimet Shëndetësore të Integruara” (IHS), për të kontribuar në përmirësimin e shëndetit të popullatës përmes përsosmërisë në kërkime, shërbime, mësimdhënie dhe trajnime në Kosovë. Projekti IHS, fton kompanitë e interesuara legale ndertimore që të dorëzojnë ofertat e tyre për realizimin e punëve renovuese/ndertimore në përputhje me kushtet dhe specifikacionin e detajuar në dokumentin e tenderit. Projekti synon të angazhojë kompanitë ndertimore për kryerjen e:

Punëve ndertimore/ renovuese për Zhvillimin e Sistemit të Strukturuar të Triazhimit dhe Optimizimin e Shfrytëzimit të Hapësirës së Triazhit në Spitalin e Përgjithshëm në Komunën e Pejës.

Kompanitë e interesuara për aplikim mund ta paraqesin kërkesën për marrje të dosjes së tenderit, cdo ditë pune prej orës 8:30-16:30, duke kontaktuar zyrën e IHS Projektit në Kosovë, përmes e-mail adresës: procurement@ihsproject.org e ku përveç kërkesës duhet të paraqesin edhe të dhënat e kompanisë si: **Emrin e kompanisë dhe Numrin unik identifikues**. Afati i fundit deri kur Operatorët Ekonomik mund ta kërkojnë dosjen e tenderit është data: 13.08.2025 ora 09:30 AM. Pas pranimit të kërkesës, dokumentacioni do t’ju dërgohet kompanive përmes emailit. Të gjitha detajet e nevojshme për aplikim i gjeni në dosjen e tenderit.

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave është **13.08.2025, në ora 11:30 AM**, adresa: **Rr. Tirana, Prime Residence, hyrja. A, kati. 9, Ap. 20, 10000 Prishtinë, Kosovë**. Ofertat duhet të dorëzohen në formatin si vijon: 1 Original + 1 kopje fizike e ofertës si dhe 1 USB apo CD- (forma elektronike e cila duhet ta përmbajë të gjithë dokumentacionin e ofertuar nga OE) dhe se bashku duhet të dorëzohen në një zarf të vetëm të mbyllur. Oferta duhet drejtuar për IHS Projektin dhe në zarf duhet të shenohet: “Punët ndertimore/ renovuese për Zhvillimin e Sistemit të Strukturuar të Triazhimit në Spitalin e përgjithshëm në Komunën e Pejës”, dhe numri i referencës: ITT/IHS/2025/001.

Shenim: VIZITA NE TERREN është e obligueshme. Operatorët Ekonomik (OE) inkurajohen të vizitojnë dhe shqyrtojnë vendin e punimeve dhe rrethinën e tij për të marrë të gjitha informatat që mund të jenë të nevojshme rreth përgatitjes së ofertës. Mospjesmarrja e Operatorit Ekonomik (OE) në viziten në terren nënkupton edhe refuzimin e Operatorit Ekonomik. Vizitat në terren janë parapare dy here, me datat: 01.08.2025 dhe me 05.08.2025. Operatori Ekonomik (OE) mund të marrë pjesë në njërin ose në të dy vizitat në terren. Për konzorciumet; mundet të marrin pjesë njëri apo të gjithë anëtarët e konzorciumit të OE.

Lokacioni dhe koha e vizites:

- Spitali i Përgjithshëm në komunën e Pejës (reparti i Emergjencës) ora 11:00 AM,

Për informata shtesë, mund ta kontaktoni IHS Projektin në email adresën si mëposhtë:
procurement@ihsproject.org

OJQ Swiss TPH, zyrja në Kosovë
Projekti IHS